



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/10/24

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga Kallxo.com përmes përfaqësuesit të zyrës ligjore ndaj gjyqtarit A.A, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 26.06.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ushtruar nga Kallxo.com përmes përfaqësuesit të zyrës ligjore, ndaj gjyqtarit A.A për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Me datë 30 Maj 2024 përmes e-mail-it zyrtar Kallxo.com përmes përfaqësuesit të zyrës ligjore, ka paraqitur kërkesë për inicim të procedurës disiplinore për gjyqtarin A.A për shkak të pretendimeve për shkelje disiplinore. Me datë 31 Maj 2024 lidhur me ankesën është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Parashtruesi i ankesës në shkresën e tij ka deklaruar se gjyqtari A.A në trajtimin e rastit lidhur me veprën penale “Dhënie e Ryshfetit” në bashkëkryerje nga neni 429 par.2 dhe 3 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës ndaj të akuzuarve A.H, A.B, A.T, D.S dhe A.B etj, ka ndërmarrë veprime të pa-renditura sipas Kodit të Procedurës Penale. Sipas parashtruesit të ankesës, gjykatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 21.03.2024 gjyqtari A.A ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të kodit të procedurës penale, ku nuk i ka marrë për bazë deklaratimet e të akuzuarve në momentin kur kanë deklaruar se nuk e kuptojnë aktakuzën, pasi janë pyetur lidhur me deklarinimin e fajësisë për ndryshimin ose sqarimin që ka bërë prokurorja Arbëresha Shala në aktakuzën PPS.nr.93/24. Sipas parashtruesit gjyqtari A.A ka vazhduar rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor duke konsideruar se të gjithë të akuzuarit janë deklaruar të pafajshëm, përkundër faktit se disa prej tyre janë deklaruar se nuk e kuptojnë aktakuzën, e precizuar a po ndryshuar, pasi që nuk iu është dorëzuar në gjuhën të cilën ata e kuptojnë. I pandehuri A.H është shprehur se nuk e kupton aktakuzën pasi nuk e ka pranuar shkresën në gjuhën të cilën ai e kupton, por sipas parashtruesit të ankesës gjyqtari A.A këtë deklarinim e ka konstatuar si mos pranim fajësie, ku lidhur me këtë është bashkangjitur edhe transkriptimi nga audio incizimi.

Tutje parashtruesi ka deklaruar po ashtu se edhe i akuzuari tjetër B.P thirret që të pyetet për deklarim të fajësisë ku i njëjti deklaroi se nuk i ka shkresat në gjuhën që ai e kupton, mirëpo përkundër kësaj gjyqtari A.A e konstatoi në procesverbal se B.P është deklaruar i pafajshëm. Sipas parashtruesit, rrjedha e procedurës në parim evidentohet në procesverbal me qëllim që shkallët e tjera të gjyqësorit të mbështeten në shkresat e lëndës, por kjo përkundër shkeljeve procedurale të vazhdueshme, kjo seancë është evidentuar edhe me një shkelje tjetër ku deklarimi i të pandehurit B.P në procesverbal nga gjyqtari është konstatuar se nuk e pranon fajësinë, gjë e cila nuk është thënë nga i akuzuari në momentin që është pyetur për pranimin e fajësisë.

Tutje parashtruesi i ankesës ka deklaruar se me këto veprime të gjyqtarit konsiderojmë se është shkelur dispozita e Kodit të Procedurës Penale neni 241 “ Pranimi i fajësisë” paragrafi 4 në të cilën specifikohet qartë se pasi që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues bindet se i pandehuri e kupton akuzën i ofron të pandehurit të drejtën që të deklarohet rreth fajësisë për veprën penale për të cilën akuzohet. Në të kundërtën nëse i pandehuri deklarohet se nuk e ka kuptuar aktakuzën, gjyqtari që është duke gjykuar çështjen thërret prokurorinë që të shpjegojë aktakuzën të pandehurit në mënyrë që ai ta kuptoj atë pa vështirësi. Mirëpo, në këtë rast gjyqtari nuk e merr mundin që të thërret prokuroren e çështjes për të shpjeguar aktakuzën të akuzuarit, por gjyqtari A.A insiston që të marrë përgjigje nga i akuzuari rreth deklarimit të fajësisë. Sipas parashtruesit rast tjetër gjatë kësaj seance është edhe deklarimi i të pandehurit A.T i cili pasi është deklaruar i pafajshëm, ka specifikuar se ndryshimi ose precizimi nuk i janë dhënë në gjuhën që ai e kupton, por gjyqtari A.A përsëri nuk e ka marrë për bazë këtë deklarim të të akuzuarit duke u thënë se të gjitha këto pretendime do të shqyrtohen gjatë shqyrtimit gjyqësor. Mirëpo, sipas tyre këto thënie nuk gjejnë mbështetje askund në Kodin e Procedurës Penale pasi që këto veprime bien ndesh me dispozitat e kodit të procedurës penale konkretisht nenin 14 “ Gjuhët dhe Shkrimi “ paragrafi 3 në të cilin theksohet se i pandehuri i cili nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, ka të drejtë në përkthim të cilësisë të mjaftueshme, veçanërisht për tu siguruar që ai ka njohur të rastit kundër tij dhe është në gjendje të ushtroj të drejtën e tij të mbrojtjes. Tutje parashtruesi ka deklaruar se këto veprime të gjyqtarit janë në kundërshtim të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, neni 5 paragrafi 2, pika 2.2. në të cilin specifikohet se gjyqtari bënë shkelje të detyrave të tij nëse përfshihet në veprimet e specifikuar nga dashja a po nga pakujdesia e rëndë “ Nuk i trajton siç kërkohet me ligj palët në procedurë, përfaqësuesit e tyre, dëshmitarët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë”.

Në fund ka deklaruar se nga këto veprime kemi shkelje të qarta të drejtave themelore të të akuzuarit në procedurë penale, pra fillimisht duke mos e trajtuar prokurorinë që të qartësoj pjesën e ndryshuar ose precizuar të aktakuzës, duke mos e obliguar prokurorinë që të dorëzoj shkresat e saj në gjuhën të cilën e kupton i akuzuari, dhe në fund duke mos i konstatuar fjalët e të akuzuarit në procesverbal ashtu siç janë deklaruar se në gjykim. Duke mos bërë konstatime të sakta të asaj çfarë ka ndodhur në seancë dhe çka është folur, do të krijohet perceptim nga gjykatat e shkallëve të tjera ndryshe nga ajo e cila në të vërtetë ka ekzistuar.

Në lidhje me pretendimet e parashtruara, gjyqtari A.A ka deklaruar se me datën 21.03.2024 në lëndën penale PKR.nr.41/18 është caktuar shqyrtimi gjyqësor, ku është dhënë fjala hyrëse nga palët, ku gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor të pandehurit A.H, etj... kanë qenë të përfaqësuar nga mbrojtësit e tyre, të angazhuar sipas autorizimit. Pas precizimit të aktakuzës nga prokurorja e

shtetit, gjykata edhe një herë i ka ftuar të akuzuarit të deklarohen për fajësinë konform nenit 319 të KPPRK-së, ku të njëjtit janë deklaruar të pa fajshëm për akuzën. Ndërsa të pandehurit A.H, B.P dhe M.Ç e kanë njoftuar gjykatën se shkresat e prokurorisë nuk janë të përkthyer në gjuhën e tyre, siç e kanë deklaruar edhe në të gjitha shqyrtimet e kaluara, e për këtë arsye deri më tani nuk arritur asnjë herë të mbahet shqyrtimi gjyqësor në lidhje me këtë çështje penale, siç shihet edhe në procesverbalin e datës 24.03.2022 ku kjo lëndë është udhëhequr nga një trup tjetër gjykues.

Tutje ka deklaruar se në shqyrtimin e datës 24.01.2024, ku i njëjti e ka udhëhequr këtë seancë në cilësi të KTGJ-së, ka kërkuar nga prokurori i shtetit të precizojë aktakuzën, ku prokurorja e shteti ka dorëzuar parashtresën e datës 24.04.2017, ku është njoftuar gjyqtarja Sh.G në lidhje me dëshminë e dorëzimit të shkresave të lëndës të pandehurve A.H, etj...ku sipas urdhëresës PKR.nr.369/16 është urdhëruar prokuroja speciale që t'i dorëzoj gjykatës të gjitha provat e përkthyer në gjuhën maqedone për të akuzuarin B.P, me aktvendimin e kolegjit shqyrtues KP.nr.577/17 të datës 17.05.2017, është aprovuar kundërshtimi i PSRK-së dhe është anuluar urdhëresa PKR.nr.369/16, me arsyetimin se prokurori i shteti ka përmbushur obligimi sa i përket dorëzimit të shkresave të lëndës.

Sa i përket pretendimit se në seancën e datës 21.03.2024 se të pandehurit nuk e kanë kuptuar aktakuzën, ky pretendim nuk qëndron pasi që të pandehurit kanë kërkuar sqarime shpesh, e të cilat i ka bërë prokuroja e shtetit dhe pas konsultimit me mbrojtësit e tyre të njëjtit vetëm kanë dhënë vërejtjet e tyre lidhur me përkthimin e shkresave në gjuhën e tyre, e të cilat vërejte janë konstatuar edhe në procesverbal, pasi që të njëjtit kanë qenë të njoftuar lidhur me aktakuzën qysh në seancën fillestare, ku të njëjtit janë deklaruar të pa fajshëm, të pandehurit dhe mbrojtësit kanë ushtruar kërkesë për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave, e për të cilat ka vendos KTGJ me datën 09.07.2019, andaj një pretendim i tillë se të njëjtit nuk e kanë njoftuar akuzën është i pa vërtet, për shkak se këtë vendim e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit me aktvendimi PN.S.nr.15/2019 të datës 18.11.2019.

Tutje gjyqtari i çështjes ka deklaruar se në seancën e datës 21.03.2024 pasi që të pandehurit janë deklaruar të pafajshëm, është dhënë fjala hyrëse nga prokurori i shtetit, të dëmtuarit dhe mbrojtësit e të pandehurve, ndërsa me datë 26.03.2024 janë dëgjuar dëshmitarët A.GJ dhe E.B dhe të pandehurit nuk kanë dhënë vërejte në rrjedhën e procedurës, dhe seancat e parapara të mbahen për datën 21-22 dhe 31 maj 2024 janë anuluar në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit dhe seancat e radhës janë caktuar edhe në muajin korrik ku do të vazhdohet edhe me dëgjimin e dëshmitarëve, vlen të ceket se të gjitha procesverbalet janë të nënshkruar nga të gjitha palët dhe asnjë herë nuk ka pas vërejte në udhëheqjen e procedurës në mua si KTGJ dhe as në ATGJ.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka ardhur në përfundim se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.A.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, për Autoritetin Kompetent ishte e rëndësishme gjetja e shkeljeve të cilat ishin pretendime të ankuesit e që parashihen me nenin 5 par. 2 pika 2.2 të Ligjit Nr. 06/L

– 057, “ Nuk i trajton siç kërkohet me ligj palët në procedurë, përfaqësuesit e tyre, dëshmitarët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë”.

Bazuar në shkresat e lëndës penale, Autoriteti i kësaj Gjykate gjeti se të pandehurve në seancën e datës 21.03.2024, ju është lexuar aktakuza PPS.nr.93/14, PPN.nr.310/15 e datës 14.06.2016, ku kanë qenë prezent edhe përkthyesit, e për të cilën aktakuzë të pandehurit kanë qenë të njoftuar edhe gjatë shqyrtimit fillestare dhe të dytë të mbajtura më herët, po ashtu që nga ajo kohë kanë pas aktakuzën në gjuhën të cilën të njëjtit e kuptojnë. Ndërsa, seanca e datës 21.03.2023 ka qenë fillim i shqyrtimit gjyqësor dhe meqenëse ka filluar rishtas, gjyqtari i çështjes në bazë të dispozitave ligjore, i ka obliguar palët që të deklarohen në lidhje me fajësinë. Ndërsa, pretendimi i ankuesit se nuk është përfillur fakti se palët janë deklaruar se nuk e kuptojnë aktakuzën, është i pabazuar sepse të njëjtit janë deklaruar për këtë aktakuzë në seancat e mëhershme ku edhe kanë paraqitur kërkesë për hudhje dhe kundërshtim të provave. Vlen të theksohet se kjo aktakuzë ka kaluar konfirmimin edhe nga Gjykata e shkallës së dytë sipas vendimit PN.S.nr.15/19 të datës 18.11.2019

Sa i përket pretendimit, se të pandehurve nuk ju është dorëzuar precizimi i aktakuzës nga ana e prokurorisë i datës 08.03.2024 në gjuhën të cilën e kuptojnë, kjo nuk qëndron pasi që nga deklarata e gjyqtarit dhe shkresat e lëndës shihet se gjyqtari ka kërkuar vetëm sqarime nga ana e prokurorisë në lidhje me aktakuzën, të cilën përgjigje prokuroria e ka kthyer me datën 08.03.2024, por që gjyqtari ka vlerësuar se përgjigja nuk ka ndryshuar gjendjen faktike të aktakuzës dhe e njëjta nuk është trajtuar si precizim nga i njëjti pasi që prokuroria e rastit ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës fillestare PPS.nr.93/14, PPN.nr.310/15 e datës 14.06.2016, me arsyetim se kjo aktakuzë e ka kaluar konfirmimin dhe në këtë fazë të procedurës nuk mund të ndryshoj asgjë. Pavarësisht kësaj, në shkresat e lëndës gjendet se përgjigja e prokurorisë e datës 08.03.2024 ju është dorëzuar mbrojtësve të të pandehurve përmes adresës elektronike.

Vlen të theksohet se prokuroria këtë përgjigje e ka dorëzuar vetëm në gjuhën shqipe, por as mbrojtësit nuk kanë kërkuar që tu përkthehet.

Qëndron fakti se të pandehurit kanë parashtruar kërkesë për përkthim të shkresave të lëndës jo vetëm tani por edhe në shqyrtimet e mëparshme, pasi që pretendojnë se nga ana e Prokurorisë nuk i kanë pranuar të gjitha shkresat e lëndës në gjuhën që e kuptojnë, por që nga ana e gjykatës është vlerësuar se shkresat kryesore relevante për këtë lëndë janë të përkthyer në gjuhën që të pandehurit e kuptojnë, andaj me qëllim të efikasitetit dhe mos zvarritjes së mëtutjeshme të kësaj lënde, pretendimet për përkthim edhe të ndonjë shkresë tjetër eventuale, gjyqtari i çështjes ka të drejtën e trajtimit gjatë procedurës gjyqësore, në bazë të kompetencave dhe autorizimeve që të autorizoj prokurorinë për përkthim.

Në lidhje me pretendimin për mos përkthim të të gjitha shkresave të kësaj lënde, vlen të theksohet se në shkresat e lëndës gjendet edhe vendimi KP.nr.577/17 të datës 17.05.2017 i nxjerrë nga Kolegji Shqyrtues i Gjykatës Themelore në Prishtinë, i cili ka konstatuar se Prokuroria Speciale ka respektuar dhe zbatuar drejtë dispozitat ligjore në lidhje me sigurimin e të drejtës në përkthim për të gjitha palët në procedurë.

Bazuar në faktet e çështjes, Autoriteti i kësaj Gjykate vlerëson se veprimet e gjyqtarit nuk paraqesin bazë për shkelje disiplinore pasi që gjyqtari nuk ka vepruar në kundërshtim me ligjin

dhe rrjedhimisht nuk ka pasur as shkelje të ligjit në kuadër të shkeljeve disiplinore nga neni 5 i Ligjit Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Sa i përket pretendimeve të tjera për shkelje disiplinore nga Neni 5 parag. 2.2 të Ligjit, për mos trajtimin të palëve sipas Ligjit, Autoriteti i Gjykatës vlerëson se në asnjë prej veprimeve të gjyqtarit nuk rezulton trajtimi jo i drejtë i palës para Ligjit, por pretendimet e parashtruara nga ankuesi mund të jenë pretendime për shkelje procedurale të cilat mund të atakohen nga palët me ankesë në Gjykatën e Apelit, pasi të merret vendimi përfundimtar në lidhje me çështjen gjyqësore. Gjykata e Apelit si shkallë e dytë është kompetente që të shqyrtoj sipas detyrës zyrtare nëse ekzistojnë shkelje të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384 paragrafit 1 të KPRK-së.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/10/24, me datë 26.06.2024

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë